




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN



VENDIM

Nr.14, datë 24.03.2022

PËR

**MIRATIMINE RINOVIMIT TË LEJES SË PËRDORIMIT TË  
BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM  
HIDROENERGJETIK, ME NR. 11, DATË 04.11.2009 DHËNË NGA  
KBU SEMAN, SUBJEKTIT "OSTROVICA ENERGY"**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e rinovimit të lejes së përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik, menr. 11, datë 04.11.2009 dhënë nga KBU Seman, subjektit "Ostrovica Energy", me adresë Njësia administrative Leshnje Skrapar Qarku Berat.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

**HEC Faqekuqil (në përroin e Faqekuqit)**

Vepra e marrjes 1

- X = 534059; -Y = 4490801; -Z = 1370m.m.n.d.(KRGJSH)
- Prurja llogaritëse  $Q_{llog}$  – 950l/s
- Prurja mesatare  $Q_{mes}$  – 880l/s

- Prurja ekologjike  $Q_{eko} - 151/s$

Kuota e Godinës së Centralit – 971 m.m.n.d

### **HEC Faqekuqi 2 (në përroin e Kapinovës)**

- $X = 532238$ ;  $-Y = 4491510$ ;  $-Z = 970$  m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse  $Q_{llog} - 21001/s$
- Prurja mesatare  $Q_{mes} - 12911/s$
- Prurja ekologjike  $Q_{eko} - 251/s$

Kuota e Godinës së Centralit – 806 m.m.n.d

3. Zbatimi i kontratës konçesionare nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Instalimi i stacioneve hidrologjikë pranë çdo vepre marrje dhe stacionit meteorologjik tek godina e centralit duhet të bëhet brenda datës 18.04.2022 sipas afatit të vendosur në “Aktmarrëveshjen” me subjektin “Elektronika Industriale 2” sh.p.k, në të kundërt pushohet fuqia juridike e vendimit.
5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

**KRYETARI I KBUSEMAN**

**LEFTER SHEHAJ**

